

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	04/01/2023	Kërkesë për informacion ardhur nga subjekt privat: 1. Kopje të Planeve të Marshtrimit të Pyjeve të Bashkisë Korçë të miratuara. 2. Studime Analiza Vlerësime në lidhje me efincën e energjisë për Bashkinë Korçë që Agjencia Kombëtare e Pyjeve disponon.	12/01/2023 Deleguar Bashkisë Korçë	Trajtuar nga institucioni përgjegjës.	E deleguar	Nuk ka
02	10/01/2023	Kërkesë për informacion mbi gjenralitetet e palës debitore të individit, ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit.	11/01/2023 Deleguar - Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile 03/02/2023 Deleguar - Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë	Trajtuar nga institucioni përgjegjës.	E deleguar	Nuk ka

03	19/01/2023	Kërkesë për informacion: A ka Ministria e Mjedisit një plan veprimi për investimet e gjelbra në Shqipëri? Nëse po, ju lutem më dërgoni një kopje.		Trajtuar nga institucioni përgjegjës.	E deleguar	Nuk ka
04	10/03/2023	Kërkesë për informacion mbi Listën e targave të automjeteve në përdorim nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve	30/03/2023	Më poshtë gjeni listën e targave të automjeteve në përdorim nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve: 1. AB 402 DK - Automjet Tip Mitsubishi Eklipse Cross (Fuoristradë); 2. AA 190 JM - Automjet Tip HYUNDAI IX 35 (Fuoristradë); 3. AA 542 PK - Automjet Tip TOTOTA PRIUS (Autoveturë); 4. AB 978 GB - Automjet Tip CHEVROLET KLAC (Fuoristradë); 5. TR 8785 L - Automjet Tip Mitsubishi Pajero (Fuoristradë); 6. TR 8733 L - Automjet Tip Mitsubishi Pajero (Fuoristradë).	E plotë	Nuk ka
05	20/03/2023	Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetare investigative: 1.Më 24 dhjetor 2020, Këshilli i Ministrave miratoi buxhetin për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Informacionit mbi Pyjet, ALFIS, një sistem dixhital që synonte inventarizimin e pyjeve dhe më pas monitorimin dhe ruajtjen e tyre. Por sipas një auditi të Kontrollit të Lartë të Shtetit, inventarizimi i fundit i kryer i përket vitit 2018 dhe sistemi ALFIS nuk është tërësisht funksional. Në cilën fazë gjendet sot inventarizimi i	27/03/2023	1.Sistemi i informacionit të pyjeve ALFIS është ngritur në kuadër të Projektit të Shërbimeve Mjedisore me financim të Bankës Botërore nepermjet kontrates te lidhur midis Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit dhe “Joint Venture Arcadia” qe perfshin periudhen 2018-2021.Agjencia Kombetare e Pyjeve ka filluar të funksionojë në shtator të vitit 2020 dhe në lidhje me fondin e akorduar për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Informacionit mbi Pyjet ju duhet ti drejtoheni MInistrisë së Turizmit dhe Mjedisit mbasi zhvillimi i ALFIS-it ka nisur që në vitin 2018.Ju bëjmë me dije se Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve 2018-2021 është një process monitorimi i pavarur dhe teknikisht nuk lidhet me informacionin dhe funksionet që kryen ALFIS. ALFIS është testuar per funksionalitetet dhe i është dorëzuar AKSH-it për të vazhduar me tenderimin e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të tij për të vazhduar më tej me vënien në përdorim nga Bashkitë, MTM, AKP dhe aktorë të tjerë të sektorit pyjor e më gjerë. Jemi në	E plotë	Nuk ka

		<p>pyjeve dhe cilat janë arsyet që sistemi ALFIS nuk është vënë ende në funksion të plotë?</p> <p>2.Sa ka kushtuar ngritja e Sistemit ALFIS dhe si janë shpenzuar fondet e vëna në dispozicion nga qeveria dhe donatorët e tjerë?</p> <p>3.Kërkojmë të na vihet në dispozicion lista e sipërfaqeve të hequra apo në proces heqjeje nga fondi pyjor për shkak të investimeve strategjike, e ndarë sipas sipërfaqes, vendodhjes së saj sidhe subjektit përfitues të shpallur investitor strategjik për vitet 2016-2022.</p>	<p>pritje të zhvillimit të kësaj procedure për të filluar zyrtarisht vënien në funksion të sistemit mbasi pa një kompani mirëmbajtjeje që të përgjigjet gjatë fazës së përdorimit/implementimit për problematikat që mund të hasen. Informacioni fillestar i hedhur në ALFIS është informacion historik i vitit 1985 vit ku i gjithë territori ka qënë i mbuluar me plane menaxhmi duke bërë azhurnimet e nevojshme sipas rastit. Sistemi është i përbërë nga 8 module të cilat janë gjithashtu edhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, që do të thotë të dhënat e futura në një modul rëflektohen edhe në modulet e tjera kur kemi të bëjmë me lidhje llogjike mes tyre. Funksionalitetet e këtyre moduleve janë testuar nga specialistët të AKP dhe janë brenda standartit të parashikuar. Jemi në pritje të përfundimit të tenderimit nga ana e AKSH-it për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit në mënyrë që të fillojmë përdorimin zyrtarisht të tij. Gjatë fazës së testimit specialistët nga AKP dhe Bashkitë kanë adresuar gjetjet për përmirësim dhe përdorim sa më eficient dhe sa më të qëndrueshëm mbasi nuk mund të pretendohet perfeksion në një sistem kaq kompleks. Një nga shqetësimet ka qënë dhe zhvillimi i një softueri për përpunim dhe transferim automatik të të dhënave të Planeve të Menaxhimit në sistem, mbasi hedhja e të dhënave manualisht shoqërohet me kosto financiare dhe rritje të marzhit të gabimit.</p> <p>2.Për sa i përket informacionit në lidhje me fondet e harxhuara ju bëjmë me dije se kontrata është lidhur me MTM dhe implementimi është ndjekur nga projekti i Shërbimeve mjedisore, ndaj ky informacion duhet të merret në MTM.</p> <p>3.Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha; c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha. <p>Gjithashtu Vendimi nr.888, date 27.12.2022 , “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e</p>		
--	--	---	---	--	--

				<p>kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” rregullon procedure e heqjeve apo ndryshimeve të destinacionit të fondit pyjor kombëtar. Për sa më sipër ju bëjmë me dije se deri tani nuk ka aplikime për heqje nga fondi pyjor për investimet strategjike. Sipërfaqet e planifikuara për Investime Strategjike i gjeni të përcaktuara me VKM Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier”. Sipas vendimit të KIS nr 11/9 date 02.12.2021 shoqëria “Mediterranean wave” merr statusin investitor strategjik për një sipërfaqe prej 63 ha që shtrihet nga plazhi i Gjeneralit deri tek rruga auto e Bardhor kepi i Lagjit, për të cilën nuk është bërë aplikimi për heqjen nga fondi pyjor.</p>		
--	--	--	--	---	--	--